



Prishtinë, 22.03.2024
Kodi i ZRRE-së: V_V_1879_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2490_02_24** i datës 07.02.2024;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës 28.02.2024.

në seancën e mbajtur më datë 22.03.2024 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** Kundërshtimi i KESCO-s, ndaj Vendimit të DMK-së për konsumatorin SH.R DPR – 90106149, si i pabazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRRE/DMK_V_2490_02_24 i datës 07.02.2024.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 07.02.2024 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2490_02_24 me të cilin e ka aprovuar ankesën e konsumatorit SH.R, nga Komuna e Prishtinës dhe e ka obliguar KESCO-n që ta anulojë korrigjimin e datës 12.10.2023 në vlerë prej -840.63 € dhe e ka obliguar që të bëjë korrigjimin në vlerë prej -2,112.43 €, duke e bërë shpërndarjen e kWh për periudhën 07/2020 deri me 07/2023.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, Furnizuesi KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Se korrigjimi i anuluar është në përputhshmëri të plotë me rregullat në fuqi;
- Njehsori nr. 67269108 i ka ruajtur të dhënat e regjistruara dhe shpërndarja e kWh të shpenzuar është bërë për periudhën 05/2022 deri me 07/2023;
- DMK nuk ka paraqitur prova që konstatohet se leximi manual është bërë gabim apo për arsye të tjera që ky lexim nuk mund të merret parasysh.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 22.03.2024 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për



Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Kundërshtimin e KESCO-s të datës 28.02.2024; Vendimin e DMK-së të datës 07.02.2024; Kalkulimin e korrigjimit të datës 28.02.2024; Kalkulimin e korrigjimit të datës 30.03.2024; Ankesën e konsumatorit në DMK/ZRrE të datës 24.10.2023; Vendimin e KESCO-s të datës 13.10.2023; Procesverbalin e inspektimit të datës 31.08.2023; Procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik të datës 26.09.2023; Rrjedhën e energjisë elektrike, Transaksionet dhe Listat e Leximit dhe Korrigjimin e datës 12.20.2023.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Kundërshtimi i KESCO-s është i pabazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se, Departamenti i faturimit në KESCO me datë 29.07.2023 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën korrik 2023, me **37,727 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **4,515.30€**. Me datë 31.07.2023 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar faturën e muajit korrik 2023 për shkak të dyshimit në leximin dhe faturimin jo të saktë me njehsorin elektrik nr. 67269108. Pas ankesës së konsumatorit, me datë 31.08.2023 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve në njehsorin elektrik nr. 67269108 ku TL=034346 kWh dhe TU=029057 kWh. Me datë 26.09.2023 ekipet e KEDS-it të autorizuar për ndërrimin e njehsorëve elektrik kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 67269108 me gjendje TL=034862 kWh dhe TU=025737 kWh dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 67273124 me gjendje TL=014638 kWh dhe TU=006790 kWh.

Bordi i ZRrE-së ka analizuar me kujdes Procesverbalin e Inspektimit të datës 31.08.2023 dhe ka gjetur se, pas shqyrtimit të gjendjes së shpenzimeve të evidentuara dhe gjendjen reale të faturuar dhe lexuar në periudhën gusht 2023 (datë 30.08.2023), është konstatuar se, ekipet e KEDS-it nuk kanë evidentuar saktë gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik me nr. 67269108 për shpenzimet e tarifës së ulët. Sipas CCP – gjendja e faturuar në periudhën gusht 2023 është TL = 34327 kWh dhe TU=25031 kurse në procesverbalin e inspektimit të datës 31.08.2023 TL=034346 kWh dhe TU=029057 kWh.

Po ashtu, Bordi ka shqyrtuar edhe Procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik të dt. 26.09.2023 dhe ka konstatuar se, gjendja e shpenzimeve të evidentuara në procesverbalin e ndërrimit dhe gjendjen reale të faturuar dhe lexuar për periudhën gusht 2023, përputhen mes vete.

Në të njëjtën kohë Bordi i ZRrE-se ka analizuar edhe rrjedhën e energjisë elektrike si dhe listat e leximit dhe konstaton se konsumatori nuk ka pasur lexime të rregullta mujore dhe se leximi i shpenzimeve të konsumatorit me njehsorin elektrik nr. 67269108 është bërë përmes leximit manual dhe me sonda dhe se është evidentuar se konsumatori që nga muaji 07/2020 deri në periudhën 08/2022 është faturuar vetëm me taksa dhe vlerësuar pasi që lexuesi i KEDS-it ka evidentuar se nuk ka qasje në leximin e shpenzimeve kurse periudhën 09/2022 deri në periudhën 02/2023 ka evidentuar se ka bërë lexime manuale kurse periudhën 03/2023 deri në periudhën 06/2023 prapë është faturuar vetëm me taksa



pasi që lexuesi i KEDS-it ka evidentuar se nuk ka qasje ne leximin e shpenzimeve kurse ne periudhën 07/2023 kemi faturim te kWh te grumbulluar. Mos qasja ne leximin e shpenzimeve mujore është ne kundërshtim me nenin 25 paragrafin 1 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: *“Konsumatori është i obliguar që të ju lejojë qasje në pronën e tij, përfaqësuesve të Operatorit të Sistemit/Furnizuesit, për qëllim të leximit, testimit, inspektimit, instalimit, mirëmbajtjes, riparimit të matësve, kyçjeve dhe pajisjeve përkatëse ashtu si paraqitet në Nenet 28, 29 dhe 30 të Ligjit për Energji.*

Departamenti i faturimit ne KESCO me datë 12.10.2023 përmes korrigjimit nr.103383DPR-90106149 ka bere korrigjimin e faturave për periudhën 05/2022 deri ne periudhën 07/2023 ne vlerë **-840.63 €** duke bere shpërndarjen e kWh për periudhën 15 mujore përkatësisht periudhën 05/2022 deri ne periudhën 07/2023 duke marr për baze leximet softwerike si dhe rrjedhën e energjisë elektrike. Bordi ka shqyrtuar korrigjimin e bërë nga Departamenti i faturimit ne KESCO dhe konstaton se KESCO ka gabuar pasi qe nuk ka marr për baze faktin se konsumatori nuk ka pasur lexime te sakta mujore nga periudha 07/2020 deri ne periudhën 07/2023 andaj edhe është dashur te beje korrigjimin për periudhën 07/2020 deri ne periudhën 07/2023. Bordi vlerëson se, konstatimi i DMK-së për shpërndarjen e kWh te faturuara për këtë periudhe është i sakte dhe se konsumatorit duhet ti behet korrigjimi financiarë ne vlerë **-2,112.43 €**. Mos faturimi i saktë mujor dhe korrigjimi është ne kundërshtim me nenin 28 paragrafin 1,2 dhe 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji e ku thuhet se : *1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifat tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit.3 Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese.*

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se i licencuari KESCO në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.



Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Arta Isufi, anëtare

Adnan Preniqi, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit **SH.R** dhe
- Arkivit të ZRRE-së.